Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarina Izborna Komisija
Central Election Commission
21-06- 2022
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 833-2022

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 15.1 të Rregullës Zgjedhore 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, si dhe bazuar ne kërkesën e partisë politike për shtyrjen e afatit për mbajtjen e kuvendit zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 21.06.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për afat shtesë për mbajtjen e kuvendit zgjedhor të partisë politike Partia e Ashkalinjëve për Integrim

I. Miratohet kërkesa e Partisë Politike Partia e Ashkalinjëve për Integrim për zgjatjen afatit për mbajtjen Kuvendit zgjedhor.

II. Afati i fundit për mbajtjen e Kuvendit zgjedhor të Partisë Politike Partia e Ashkalinjëve për Integrim shtyhet deri më 31 korrik 2022.

III. Obligohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim/ZRPPC, që të njoftojë partinë politike si në piken I të këtij vendimi.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike ka pranuar kërkesë nga Partia politike Partia e Ashkalinjëve për Integrim, për zgjatjen e afatit për mbajtjen e Kuvendit zgjedhor, për shkak të problemeve financiare të brendshme dhe fillimit të vonshëm të Kuvendeve të degëve gjë që shkakton shtyrjen e Kuvendit qendror. Pas vlerësimit të kërkesës të kësaj partie, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjen kërkesën e partisë politike Partia e Ashkalinjëve për Integrim të arsyeshme andaj si e njëjtë është aprovuar. Duke pas parasysh të lartcekurat, KQZ ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi, Kryetar

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE - CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtina

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarina Izborna Komisija
Central Election Commission
21 -06- 2022
Prishtinë / Priština
Nr. 834-2022

Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 6, paragrafi 1, germa a) e Rregullës së KQZ nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 21.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e partisë politike Pokret za Župu i Dijasporu-ŽUPSKA

I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për pezullim të partisë politike Pokret za Župu i Dijasporu-ŽUPSKA për mos mbajtjen e Kuvendit zgjedhor në përputhje me nenin 15, paragrafi 1 të Rregullës Zgjedhore 01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike.

II. Në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, germa b) e Rregullës zgjedhore 01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike, partia politike Pokret za Župu i Dijasporu-ŽUPSKA obligohet që në afat të shtuar prej dyzet e pesë (45) ditëve të mbajë Kuvendin zgjedhor.

III. Obligohet Zyra të njoftojë përfaqësuesin e kësaj partie politike për marrjen e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Pokret za Župu i Dijasporu me akronim ŽUPSKA është regjistruar si parti politike me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me numër 791/2021 të datës 22 shkurt 2021 me kryetar të partisë politike Ahmed Zečirović. Në përputhje me nenin 15 paragrafi 1 i Rregullës zgjedhore 01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike, partia politike e regjistruar duhet që brenda gjashtë (6) muajsh nga data e regjistrimit të mbajë Kuvendin zgjedhor dhe më pas çdo dyzet e tetë (48) muaj. Partia politike Pokret za Župu i Dijasporu ka bërë dy kërkesa për shtyrje të afatit të fundit për mbajtje të Kuvendit zgjedhor. Kërkesa e parë ishte bërë për shkak të pamundësisë së mbajtjes së Kuvendit zgjedhor për shkak të aktiviteteve të vitit 2021 me ç'rast KQZ kishe dhënë afat shtesë deri më 31 dhjetor 2021. Kërkesa e dytë për shtyrje të afatit për mbajtje të Kuvendit zgjedhor u bë për shkak të kufizimeve në organizimin e tubimeve si rrjedhojë e gjendjes së pandemisë në vend, dhe me vendim të KQZ-së së datës 19 janar 2021 kësaj partie politike i është shtyrë afati për mbajtjen e Kuvendit deri më 31 maj 2021. Mirëpo partia politike Pokret za Župu i Dijasporu nuk ka arritur të organizojë Kuvendin zgjedhor brenda afatit të dhënë nga KQZ dhe si

rrjedhojë, në përputhje me nenin 6, paragrafi 1, germa a) e Rregullës Zgjedhore nr. 01/2013 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi, Kryetar

Këshillë juridike: *Partia Politike Pokret za Pokret za Župu i Dijasporu me akronim ŽUPSKA, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP brenda njëzet e katër (24) orëve nga pranimi i këtij vendimi.*

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarina Izborna Komisija
Central Election Commission
21 -06- 2022
Prishtinë / Priština
NrJBr. 839 - 2022

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 5, 6 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 21.06.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Z.Ninoslav Djeric,** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut, nga subjekti politik "Srpska Lista", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Radovan Tanic.

II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Ninoslav Djeric, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 07.06.2022, Nr. 764/2022, për zëvendësimin e anëtari të Kuvendit Komunal z.Radovan Tanic, me rastin e vdekjes së tij.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati në listën e rirenditur është z.Ninoslav Djeric.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.06.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina
QENDRALNA IZBORNA KOMISIJA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
21 -06- 2022
Prishtinë / Priština
Nr.Prot. 835- 2022

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 20 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-01 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe Udhëzimin Administrativ MF-Nr-01/2019, për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, si dhe vendimin Nr.1625/2021 i datës 09.06.2021, për formimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të KQZ-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 21.06.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emerimin e Anëtarit të Jashtëm të Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

I. Z. Përparim Shurdhiqi, Zyrtar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", emërohet Anëtar i Jashtëme i Komitetit të Auditimit të Brendshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Komiteti i Auditimit ushtron përgjegjësit sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Udhëzimin Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji të nxjerra në pajtim me praktikat dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.06.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA

Ky vendim i dorëzohet:

- *Z. Përparim Shurdhiqi*
- *Anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm*
- *Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së*
- *Auditorit të Brendshëm*
- *Arkivit të KQZ-së*

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarlna Izborna Komisija
Central Election Commission
21 -06- 2022
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 836-2022

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2, nenin 7 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.06.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Strategjisë së Listës Votuese të KQZ Për Vitin 2022 - 2025

I . Miratohet Strategjia e Listës Votuese të KQZ, për vitin 2022 - 2025.

II. Strategjia si në pikën I, është pjesë përbërse e këtij vendimi.

III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënështkrimit.

Prishtinë, 21.06.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina
QENDRALNA IZBORNA KOMISIJA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

STRATEGJIA E LISTËS SE VOTUESVE TË KQZ

2022 - 2025

ose

ORIENTIMET STRATEGJIKE TË LISTËS SË VOTUESVE TË KQZ – së

2022 - 2025

Qëllimi

Strategjia e listës së votuesve ka për qëllim të ndërmarrë veprime në alokimin sa më të saktë, pjesëmarrjen pa vështirësi të votuesve në ditën e zgjedhjeve, duke ju mundësuar caktimin e qendrës së votimit më të përshtatshme.

Vlerat

Regjistrimi bazohet në këto parime:



Gjendja aktuale – Përmbledhje

Lista e saktë, e përditësuar dhe e plotë e votuesve garanton një proces zgjedhor të suksesshëm. Integriteti mbetet shqetësim i vazhdueshëm. Kjo nënkupton se lista e votuesve përmban emra të personave të vdekur, që nuk janë larguar nga regjistri qendror civil dhe gjithashtu adresat e pasakta reflektohen pastaj në caktimin e saktë të votuesve në qendra të votimit. Cështje tjetër që ndërlidhet me integritetin e listës së votuesve dhe që mbetet një nga shqetësimet e vazhdueshme, është ndërlidhja e adresave në të dhënat e shtetasve me të drejtë vote në regjistrin qendror civil. Edhe pse adresa të miratuara që reflektohen në të dhënat e shtetasve, në regjistrin qendror civil, nuk përbën standardizim dhe gjithashtu, emrat e rrugëve nuk janë të plota, me të gjitha elementet shënjuese, sic janë kodet e rrugëve dhe numrat e hyrjeve.

Procedurat aktuale të regjistrimit dhe votimit jashtë Kosovës, nuk ofrojnë siguri.

KQZ-ja operon me një sistem të caktimit të votuesve i cili është krijuar 21 vjet më parë, i cili ka shërbyer për një mjedis pas konfliktit. Korniza legjislative pothuajse nuk ka ndryshuar fare që nga viti 2008. Me gjithë përpjekjet për të ndryshuar kornizën legjislative, shumë pak është arritur përmirësim në këtë drejtim, megjithëse KQZ ka ndërmarrë veprime konkrete në largimin e emrave të personave të vdekur nga lista e votuesve, ku në këtë drejtim është shënuar progres.

Proceset zgjedhore të parakohshme të mbajtura që nga viti 2008, e kanë kufizuar procesin e ndryshimit.

KQZ-ja nuk ka përgjegjësi të plotë për shumë aspekte të procesit të regjistrimit. Sfida është që të sigurohet që bashkëpunimi me partnerët e saj të regjistrimit të mbetet efektiv, veçanërisht me autoritetin e regjistrimit civil, panelin e zgjedhjeve për ankesa dhe parashtresa dhe gjykatat. Mbi të gjitha, KQZ-ja varet plotësisht nga vetë votuesit, të cilët janë përgjegjës për të siguruar që të dhënat e gjendjes civile të mbahen të përditësuara.

Pavarësisht këtyre sfidave, KQZ-ja ka treguar kapacitet të dukshëm në zbatim, pasi ka dorëzuar me sukses listat e votuesve për të mbështetur mesatarisht një palë zgjedhje çdo nëntë muaj pas inaugurimit të saj institucional në vitin 2008.

Zgjedhësit dhe subjektet politike mbeten të angazhuara në procesin zgjedhor.

Ka shenja përmirësimi, saktësia e listës së votuesve po rritet, ka mbështetje për reformën dhe një sërë nismash do të adresojnë ndjeshëm shumë nga mangësitë e raportuara nga vëzhguesit.

Angazhimi i KQZ-së për të modernizuar listën e votuesve do t'i vendosë zgjedhjet e Kosovës në mesin e më të mirave në rajon.

Gjendja aktuale – E detajuar

Përparësitë

- Rritja e cilësisë së listës së votuesve në Kosovë, veçanërisht në lidhje me largimin e personave të vdekur;
- Aftësia organizative dhe përvoja substanciale e menaxhimit të fituara gjatë nëntë zgjedhjeve në mbarë Kosovën të mbajtura që nga viti 2008;
- Certifikimi i listës së votuesve është arritur në të gjitha zgjedhjet;
- Buxhetet periodike dhe zgjedhore të financuara plotësisht dhe të qasshme sipas nevojave të regjistrimit;
- KQZ-ja ka aftësinë të ndryshojë në mënyrë të pavarur rregulloret për listën e votuesve dhe çështje të tjera të lidhura me të;
- Angazhimi i KQZ-së për reformën e regjistrimit i shprehur përmes planit të saj strategjik për të zgjidhur mangësitë e identifikuara nga vëzhguesit;
- Aftësia për të zbatuar ndryshimet për zgjedhjet lokale dhe për të zbatuar mësimet e nxjerra në zgjedhjet parlamentare.

Mangësitë

- Cenueshmëria e listës së votuesve ndaj rrezikut të bartur nga performanca e dobët e partnerëve;
- Lista e votuesve në Kosovë është e mbipërfaqësuar, kryesisht për shkak të pamundësisë për t'i larguar qytetarët të cilët janë me qëndrim të përkohshëm jashtë Kosovës;
- Mbipërfaqësimi çon në shqetësime për mashtrime të mundshme nëpërmjet votimit në vend të këtyre personave dhe në këtë mënyrë kufizon besimin në rezultatet e zgjedhjeve;
- Adresat e pasakta të votuesve për shkak të problemeve sistemike, të përkeqësuara nga përdorimi i vazhdueshëm i votimit me kusht dhe nevoja për të kërkuar dokumentacion të ri përpara se të regjistrohet ndryshimi i adresës;
- Pasaktësitë e adresave të votuesve rezultojnë në caktimin joadekuat të votuesve në qendra të votimit, ku përveç se votuesit mund të caktohen që të votojnë larg vendbanimit të tre, caktimi i pasaktë ndikon në ngarkimin me numër të madh të votuesve në disa qendra të votimit, që gjenden kryesisht në zonat urbane.
- Masat mbrojtëse të pamjaftueshme për të parandaluar keqpërdorimin e votimit me postë;
- Mbështetja në pak zyrtarë kyç të stafit në shërbimin e votuesve.
- Rregulloret aktuale nuk mundësojnë menaxhimin e vazhdueshëm të regjistrit dhe as nuk ofrojnë ndonjë udhëzim për periudhën minimale të nevojshme për të arritur nivelet bazë të cilësisë për shërbimet e votuesve ose regjistrimin dhe aplikimin e votimit përmes postës.
- Të drejtat e votuesve nuk mbrohen mjaftueshëm, duke përfshirë të drejtën për mjete juridike efektive, gjatë zgjedhjeve të parakohshme, ose gjatë kërkesave të mëdha për fletëvotime përmes postës;
- Sistemi i regjistrimit i vjetërsuar dhe i pa reformuar, i projektuar kur përparimet teknologjike ishin të kufizuara; koncept i paqartë i projektimit për të ardhmen; nuk ka plan të zbatimit.

Mundësitë

- Zhvillimet e programeve me partnerë ofrojnë mundësi potenciale për t'i zgjidhur çështjet e adresave dhe menaxhimit të diasporës dhe për t'i dhënë publikut qasje online në të dhënat e regjistrit;
- Ekziston një interes i madh politik për reformën e regjistrimit dhe Komisioni ad-hoc i Kuvendit për Reformën Zgjedhore ofron perspektiva për zhvillim substancial sistemik-legjislativ;
- Vënia në zbatim të inovacioneve të fundit teknologjike për regjistrimin dhe aktivitetet shoqëruese në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut ofrojnë mundësi transferimi të njohurive dhe të programimit;
- Ekziston një gamë e gjerë e asistencës teknike në dispozicion, nga organizatat ndërkombëtare të pranishme në Kosovë (Misioni i OSBE-së në Kosovë, Misioni i BE-së në Kosovë, UNDP, etj.), rrjetet e krijuara rajonale zgjedhore të KQZ-së dhe nga anëtarësimet e saj në organizatat ndërkombëtare zgjedhore (A-ËEB,). Kosova është gjithashtu anëtare e Komisionit Evropian për Demokraci të Këshillit të Evropës / Komisionit të Venecias.

Rreziqet

- Pengesa të mëdha për ndryshim: udhëheqje dhe koordinim i kufizuar në mesin e akterëve kryesorë; kapacitete të ndryshueshme të KQZ-së për të menaxhuar reformën dhe ridizajnimin zgjedhor, si dhe për të zhvilluar zgjedhje sipas nevojës; nevoja për mbështetje të partnerëve institucionalë dhe të subjekteve politike për të arritur një reformë thelbësore; mbështetja në një komision të Kuvendit për të ndryshuar legjislacionin, anëtarësia e të cilit mund të ndryshohet pas çdo zgjedhjeje të parakohshme për Kuvendin;,
- Potenciali për ndryshim është joefektiv: vizion i paqartë dhe i pakuptueshëm; "tepër shumë, shumë shpejt"; Mbështetja e tepërt në teknologji dhe legjislacion për t'i zgjidhur çështjet; shumë/pak rregullore; një qasje parimore "Goldilocks", ku stabiliteti humbet pasi variacione të shumta duhet të provohen dhe testohen përpara se të vendoset për një zgjidhje përfundimtare; jo në përputhje me praktikat dhe standardet e mira;
- Kompleksiteti i planifikimit të zbatimit: koha e nevojshme për t'u pajtuar për hartimin e sistemit të ri, hartimin dhe miratimin e legjislacionit; kërkesa për të finalizuar ndryshimin 12 muaj përpara zgjedhjeve (për të mundësuar përditësimin e Pprocedurave Standarde të Operimit, informimin e publikut, etj.); potenciali për zgjedhje të parakohshme; orari pothuajse i njëkohshëm i zgjedhjeve lokale dhe legjislative;
- Mangësitë e mundshme të zgjedhjeve të para, veçanërisht në lidhje me kuptimin dhe përputhshmërinë e votuesve;
- Reforma e regjistrimit nuk ka gjasa, në vetvete, të zgjidhë plotësisht integritetin dhe çështjet e tjera të identifikuara, veçanërisht nëse ndërmerret në mënyrë të njëanshme, pa iu referuar reformës së përgjithshme zgjedhore dhe veprimeve gjyqësore;
- Aftësia e ndryshueshme promovuese e KQZ-së për të arritur përkrahjen e vazhdueshme të publikut për reformën e regjistrimit, ndërtimin e besimit dhe luftimin e keqinformimit dhe dezinformatave;
- Reforma plotësuese për të arritur modelin e avancuar demokratik zgjedhor.

Gjendja në të ardhmen

Që nga viti 2008, KQZ-ja i ka organizuar me sukses zgjedhjet si në oraret e zgjedhjeve të rregullta ashtu edhe në ato të parakohshme. Lista e votuesve është komponenti kryesor i mbajtjes së zgjedhjeve. Prandaj, KQZ-ja synon të rrisë besimin e votuesve dhe subjekteve politike në zgjedhje duke përmirësuar cilësinë dhe integritetin e listës së votuesve.

Kjo do të arrihet si më poshtë:



Strategjitë për ta arritur këtë qëllim – Përmbledhje

KQZ-ja është autoriteti i zgjedhjeve, me përgjegjësi dhe llogaridhënie për zhvillimin e suksesshëm të zgjedhjeve në Kosovë. Prandaj, KQZ-ja duhet ta udhëheqë procesin e reformës.

Një vizion i qartë, i mbështetur politikisht dhe i dakorduar se si duhet të duken zgjedhjet e ardhshme të qëndrueshme:

- Lista e votuesve në Kosovë e përditësuar
- Caktime të qëndrueshme dhe të sakta të votuesve në qendra të votimit
- Lista e votuesve jashtë Kosovës që është e qasshme dhe e mbrojtur nga keqpërdorimi.

Një qasje e integruar e partneritetit me shumë agjenci/rajonal për dizajnim dhe zbatim dhe qasje të dyfishtë ndaj reformës:

- Ku KQZ-ja do të ndërmarrë ndryshime, në mënyrë të pavarur:
  - Zhvillimi i integritetit procedural të regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës
  - Menaxhimi i procesit të caktimit të votuesve në qendra të votimit
  - Ndryshimet/ Modernizimi rregullativ
- Ku kërkohet një qasje e partneritetit me shumë institucione/ agjenci:
  - Komisioni i Kuvendit - modernizimi i kornizës; heqja e votimit me kusht
  - Ministria e Brendshme/Agjencia e Regjistrimit Civil – adresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me përditësimin dhe saktësinë e listës së shtetasve;
  - Agjencia për Informim dhe Privatësi - Pajtueshmëria
  - Partneritetet rajonale - Transferimi i njohurive.
  -

Një plan dhe orar efektiv dhe i prioritizuar i zbatimit:

- Kornizë ligjore dhe procedura operacionale moderne;
- Konfirmimi që propozimet i plotësojnë standardet dhe praktikat e mira;
- Inovacioni teknologjik;
- Pjesë e një plani të përgjithshëm strategjik zhvillimor të zgjedhjeve;
- Ngritja e vetëdijes, promovimi dhe komunikimi;
- Zhvillimi i kapaciteteve të brendshme dhe forcimi institucional;
- Asistenca teknike;
- Ruajtja e një aftësie të vazhdueshme për të zhvilluar zgjedhje rregullta ose të parakohshme;
- Planifikimi gjithëpërfshirës i "zgjedhjeve të para";
- Zbatohet në zgjedhjet lokale para zgjedhjeve legjislative;

Strategjitë për arritjen e këtij Qëllimi – E detajuar				
SHTYLLA STRATEGJIKE 1: Lista e Votuesve			**QËLLIMI STRATEGJIK: Sistem Modern i Regjistrimit**	
Veprimi strategjik Çka duhet të bëjmë për ta arritur qëllimin?	Objektivat Çka po përpiqemi të arrijmë me këtë veprim?	Aktivitetet strategjike Çka duhet të bëjmë?	Indikatorët Si e dimë nëse kemi pasur sukses? (Komisioni të përcaktojë matjen dhe orarin SMART[1] për indikatorë)	Veprimi Kush është përgjegjës dhe i përfshirë?
1. Përcaktimi i sistemit të përgjithshëm të listës së votuesve-konceptit të ridizajnimit ligjor	Lista e votuesve është e qëndrueshme dhe i plotëson nevojat e ardhshme	• Analizimi i zbrazëtirave ligjore, rekomandimeve të vëzhguesve, nevojave strategjike zgjedhore, mundësive teknologjike • Konfirmimi i nismave të programimit të partnerëve dhe orarin e tyre • Hetimi, rishikimi dhe hartimi i konceptit të operacioneve	• Koncepti dhe plani i ridizajnimit i Listës së Votuesve nga KQZ (*i dakorduar deri në qershor 2022*) : • • Plani i zhvillimit të listës së votuesve i integruar në një plan të përgjithshëm në planin strategjik të KQZ - së (nëntor 2022). • • Mbështetja e fituar nga palët e përfshira për konceptin e rishikuar [*menjëherë pas dakordimit të konceptit nga Komisioni*]	KQZ
1.1 Lista e votuesve - konsideratat e dizajnit	Lista e votuesve është aktuale, e saktë dhe e plotë	• Konfirmimi i vazhdimit të modelit të regjistrimit pasiv	• Konfirmimi nga KQZ-ja *[deri në]*	KQZ
		• Largimi ose ndryshimi i modelit të votimit me kusht	• Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme i ndryshuar [*12 muaj para "zgjedhjeve të para"*] • Përditësimet e akteve legjislative, rregullative dhe nënligjore [*deri ...*] • Numri i përditësimeve të regjistrit civil [*i rritur me ....%*] • Rritja e saktësisë së adresave të të regjistruarve • Hartohet plani për minizimin e rreziqeve nga kufizimi i të drejtave të votuesve	Komisioni i Kuvendit, KQZ, MPB/ARC

[1] SMART - Specifik: Qëllimi duhet të shënjestrojë një fushë specifike të përmirësimit ose t'i përgjigjet një nevoje specifike; I matshëm: Qëllimi duhet të jetë i matshëm, ose të paktën të mundësojë një përparim të matshëm; I arritshëm: Qëllimi duhet të jetë realist, bazuar në burimet në dispozicion dhe kufizimet ekzistuese; Relevant: Qëllimi duhet të përputhet me objektivat e tjerë të punës për t'u konsideruar se ia vlen; I kufizuar në kohë: Qëllimi duhet të ketë një afat kohor ose fund të përcaktuar

			•	
		• Zvogëlimi/parandalimi i nënpërfaqësimit dhe mbipërfaqësimit të listës së votuesve	• Procedurat standarde të operimit regjistrimin civil të rishikuara, përmirësuara dhe vendosura (numri i nismave të përbashkëta MPB/ARC, MPB/ARC-KQZ, dhe KQZ) • Plani i zbutjes së rrezikut të transferimit të regjistrit • Studimi i fizibilitetit të lidhjes së bazës së të dhënave • Numri i përditësimeve të regjistrit • Kontrollet e listave të votuesve	KQZ, MPB/ARC
		• Efektiviteti i menaxhimit të projektit	• Mirëmbajtja e vazhdueshme e listës gjatë gjithë ciklit zgjedhor [*me përditësime të listave publike çdo 6 muaj*] • Ekstraktet e regjistrit të sigurohen sipas nevojës dhe kur kërkohet • Përditësimet rregullative dhe Procedurave Standarde të Operimit, për të përfshirë kohëzgjatjen minimale të rekomanduar të aktivitetit që nevojitet për të arritur rezultate cilësore	KQZ, MPB/ARC
	Caktimi i vendvotimeve është i saktë, i qëndrueshëm dhe i menaxhuar mirë	• Vënia në zbatim e sistemit unik të adresave në mbarë Kosovën	• Nisma bashkëpunuese me MPB/ARC, AKK, Komunat, etj. • Konfirmohet përputhshmëria e sistemit të adresave me caktimin e vqendrave të votimit nga Komisioni • Konfirmohet zvogëlimi i problemeve në sistemin e adresave	MPB/SRV, AKK, KQZ
		• Lista e votuesve në Kosovë është aktuale, e saktë dhe e plotë	• Si më sipër	Si më sipër
		• Rishikimi i standardeve ekzistuese të rregulluara të caktimit të qendrave të votimit	• Procedurat standarde të operimit në identifikimin e vazhdueshëm të qendrave të votimit dhe caktimin e votuesve në QV • Përditësimet e rregulloreve dhe Procedurave Standarde të Operimit	KQZ
		• Plani për caktimin në Qendra të votimit	• Numri i votuesve / % e zgjedhësve që nuk janë brenda distancës së dakorduar nga vendbanimi	KQZ

			• Numri i vendvotimeve që tejkalojnë kufijtë e kapaciteteve të dakorduara • Numri i vendvotimeve që përmbushin caqet e tepricës së kapacitetit • Numri i qendrave të reja të votimit (veçanërisht në zonat urbane) • Numri i caktimeve të vendvotimeve që i nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme	
		• Modernizimi i periudhës së Shërbimit të Votuesve	• Përditësimet e rregulloreve dhe Procedurave Standarde të Operimit, për të përfshirë kohëzgjatjet minimale të rekomanduara të aktivitetit të nevojshme për të arritur rezultate cilësore • Numri i inovacioneve teknologjike (online, aplikacione të pajisjeve mobile, etj.) • Numri i shërbimeve online në dispozicion gjatë dhe jashtë periudhës zgjedhore	KQZ
1.2 Lista e votuesve jashtë Kosovës – konsideratat e dizajnit	Programi i modernizuar i regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës, i mbrojtur nga ndërhyrjet	• Rishikimi i mekanizmit të përfshirjes dhe autoritetit përgjegjës për votuesit me të drejtë vote që nuk janë të regjistruar në regjistrin civil	• Nisma bashkëpunuese MPB/ARC • Autoriteti i regjistrimit konfirmon përditësimet ligjore, rregullative dhe të Procedurave Standarde të Operimit • Procedurat e rishikuara të regjistrimit • Fushatë e informimit	KQZ, MPB/ARC, Komisioni i Kuvendit
		• Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave efektive për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës dhe integritetin e aplikimit	• Procesi modern i regjistrimit dhe aplikimit (p.sh. zhvillimi i një aplikacioni online për regjistrim të votuesve, me të gjitha elementet e sigurisë dhe të verifikimit) • Numri i përpjekjeve mashtruese për regjistrim • Numri i regjistrimeve të suksesshme pas korrigjimeve • Përditësimet rregullative dhe të Procedurave Standarde të Operimit	KQZ
		• Rishqyrtim i përshtatshmërisë së vazhdueshme të Panelit	• Konfirmimi i KQZ-së • Autoriteti përgjegjës i aftë të ofrojë shërbime cilësore korrigjimi, në baza individuale, pavarësisht nëse janë zgjedhjet	Komisioni i Kuvendit,

		Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për të ofruar korrigjim në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e votës	e rregullta apo të parakohshme, apo numri i lartë i kërkesave për votim nga jashtë	KQZ, PZAP, Gjykatat
1.3 Aspekte të përbashkëta të hartimit të listës së votuesve		• Sigurimi i cilësisë së regjistrimit gjatë zgjedhjeve të parakohshme	• Zgjatja e afatit për zgjedhjet e parakohshme • Përditësimet ligjore, rregullative dhe të Procedurave Standarde të Operimit.	KQZ
		• Rishqyrtimi i modelit për shqyrtim dhe verifikim të listës së votuesve	• Vlerësimi për të përcaktuar nëse statusi i integritetit të listës së votuesve kërkon apo jo një aktivitet konfirmimi dhe kundërshtimi • Konfirmimi i KQZ-së	KQZ
		• Modernizimi i aktivitetit të Kundërshtimit dhe Konfirmimit	• Procesi modern i shqyrtimit dhe verifikimit publik • Numri i inovacioneve teknologjike (online, aplikacionet e pajisjeve mobile, qasje online në listën e votuesve nga subjektet politike dhe vëzhguesit me të drejta të kufizuara qasjeje, etj.) • Numri i shërbimeve online në dispozicion gjatë dhe jashtë periudhës zgjedhore • Përditësimet ligjore, rregullative dhe të Procedurave Standarde të Operimit	KQZ, Komisioni i Kuvendit
		• Rritja e efektivitetit të menaxhimit të projekteve	• Listat e votuesve brenda dhe jashtë Kosovës i nënshtrohen verifikimit dhe shqyrtimit publik gjatë kohës së përcaktuar me ligj • Si mundësi për të vendosur lidhur me shqyrtimin e ankesave, të themelohet një komision brenda KQZ, si shkallë e parë.	KQZ. Komisioni i Kuvendit
		• Kapaciteti i forcuar teknik i Komisionit	• Organogrami i rishikuar/stafi i shërbimit të votuesve • Mbahet konferenca e përbashkët rajonale për listën e votuesve. • Numri i konferencave tematike teknike të ndjekura • Kapaciteti i përmirësuar i planifikimit të projekteve	KQZ

			• Kapaciteti i përmirësuar i analizave strategjike	
		• Qasja "Për të gjitha zgjedhjet" përmes marrëdhënieve kuptimplote me partnerë	• Numri i nismave bashkëpunuese • Numri i takimeve konsultative/koordinuese • Numri i projekteve të përbashkëta që çojnë në operacione të zgjeruara	KQZ, Partnerët
		• Ndërtimi i konsensusit për të mbështetur konceptin e Komisionit	• Numri i takimeve konsultative të mbajtura • Numri i informimeve të palëve të interesuara • Numri i takimeve publike në mbarë Kosovën • Numri i rekomandimeve të mbështetura • Drafti përfundimtar i rekomandimeve të dakorduara për dorëzim në komisionin e Kuvendit	KQZ
		• Është forcuar besimi i publikut në listën e votuesve	• Promovimi dhe vetëdijesimi i vazhdueshëm periodik (integriteti i shtuar i listës së votuesve, ndryshimet e propozuara, përditësimet e regjistrit, etj.) •	KQZ
		Reforma i plotëson standardet dhe praktikat e mira	• Miratimi i Këshillit të Evropës, ose institucionit të ngjashëm • Të drejtat e votuesve ruhen/përmirësohen • Miratimi i Agjencisë për Informim dhe Privatësi	KQZ, Agjencia për Informim dhe Privatësi, Ndërkombëtar
		• Procesi i ndryshimeve legjislative – miratimi i rekomandimeve të Komisionit për dizajnin e zgjedhjeve	• Plani i reformës legjislative dhe drafti i orarit • Numri i amendamenteve legjislative të dakorduara • Numri i rregulloreve të azhurnuara të KQZ-së • Plani operativ i regjistrimit i përditësuar • Procesi dhe sistemet e konfirmuara se janë në gjendje të ofrojnë zgjedhje të suksesshme pasuese • Reforma e përfunduar 12 muaj para zgjedhjeve	KQZ, Komisioni i Kuvendit
		• Efektiviteti Administrativ dhe Operacional i Komisionit	• Zbatimi i planit të menaxhimit të ndryshimit dhe riskut • Buxheti i miratuar dhe i alokuar;	KQZ
		• Monitorimi dhe vlerësimi	• Numri i kontrollimeve/auditimeve të kryera	KQZ

			• Numri i rregullimeve/harmonizimeve të nevojshme	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarlna Izborna Komisija
Central Election Commiss
21 -06- 2022
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 837 - 2022

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 113.3 si dhe nenin 113.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.06.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Planit të Buxhetit të KQZ për Vitin 2023-2025

I . Miratohet Plani i Buxhetit të KQZ-së, për vitin 2023-2025.

II. Plani si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënështkrimit.

Prishtinë, 21.06.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

PLANI I BUXHETIT

KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE 2023-2025

Qershor 2022

PËRKUFIZIMET 3
HYRJE 4
PLANI I BUXHETIT 2023-2025 5
Tabela 1- Buxheti për Fondin Mbështetja e Partive Politike 7
Tabela 2 - *Buxheti i Sekretariatit sipas kategorive ekonomike 2023-2025* 7
Tabela 3 - *Buxheti i Zgjedhjeve sipas kategorive ekonomike 2023-2025* 8
1. Buxheti për vitin 2022 dhe parashikimi i implementimit 9
Tabela 4. Buxheti për vitin 2022 9
2. Plani i Buxhetit për vitin 2023 10
Tabela 5- Buxheti për vitin 2023 10
Sekretariati 11
Tabela 6- Buxheti i Sekretariatit 2023 - sipas kategorive ekonomike 11
Paga dhe shtesa 11
Mallra dhe shërbime 12
Shpenzimet komunale 12
Shpenzimet kapitale 12
Zgjedhjet 13
Tabela 7–Buxheti i Zgjedhjeve 2023 sipas kategorive ekonomike 13
3.2. Vlerësimi i Buxhetit për vitin 2024 sipas programeve 15
3.2.1. Sekretariati 15
Tabela 8. Buxheti i Sekretariatit 2024 sipas kategorive ekonomike 15
3.2.2. Zgjedhjet 15
Tabela 9–Buxheti i Zgjedhjeve 2024 sipas kategorive ekonomike 16
3.2.3. Fondi mbështetja e partive politike 16
3.3. Vlerësimi i Buxhetit për vitin 2025 sipas programeve 17
3.3.1. Sekretariati 17
Tabela 10. Buxheti i Sekretariatit 2025 sipas kategorive ekonomike 17
3.3.2. Zgjedhjet 17
Tabela 11. Buxheti i Zgjedhjeve 2025 sipas kategorive ekonomike 18
3.3.3. Mbështetja e partive politike 18
4. Kërkesat shtesë buxhetore mbi kufijtë buxhetor të Qarkores 2023/01 19
Tabela 12- Buxheti i KQZ-së dhe kufijtë buxhetor 19

PËRKUFIZIMET

KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
SKQZ	Sekretariati i KQZ-së
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
LMFPP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
BBK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
SZHMB	Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
PIP	Programi i Investimit Publik
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
ZLKZ	Zyrtarët e lart komunal zgjedhor
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
VV	Vend Votimi
KVV	Këshillat e Vend Votimit
€	Euro
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik
OE	Operator Ekonomik

HYRJE

Pas aprovimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të KQZ-së për vitet 2023-2025, nga të gjitha njësitë në Sekretariat është kërkuar që të përgatisin kërkesat e tyre buxhetore për Planin e Buxhetit 2023-2025.

Sipas përgjegjësive të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve është e obliguar të nxjerr Qarkoren Buxhetore më të cilën sigurohen informata dhe udhëzime mbi përkufizimet dhe tavanet e shpenzimeve për organizatën përkatëse buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësimet jo të detyrueshme për dy vitet e ardhshme fiskale.

Qarkorja buxhetore përfshinë: procedurat që duhet të përdoren gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore, informatat që duhet të parashtrohen në propozim-buxhet, futjen e të dhënave në SZHMB dhe PIP, datën deri kur duhet të përfundohet dhe dorëzohet në Ministri propozim-buxhetin dhe kërkesa për ndarje buxhetore.

Ministri e Financave dhe Transfereve ka lëshuar Qarkoren e parë buxhetore 2023/01 në të cilën janë caktuar kufijtë dhe janë dhënë informata të mjaftuara për hartimin e Propozim buxhetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke u bazuar në udhëzimet e dhëna në Qarkoren 2023/01 ka përgatitur propozim Buxhetin për periudhën 2023-2025. Përgatitjes dhe hartimit të këtij dokumenti i ka parapri përcaktimi i objektivave të institucionit, identifikimi i nevojave dhe analiza e kërkesave nga secila njësi kërkuese buxhetore.

Mungesa e Planit strategjik ka reflektuar edhe në strategjinë dhe propozimin e planit buxhetor për tri vitet e ardhshme.

Meqenëse në vitin 2023 nuk planifikohen të mbahen zgjedhje, fokusi është përqendruar në buxhetin operacional dhe në ngritjen e kapaciteteve, fuqiziin institucional, avansimin e stafit për planifikimin, organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve ashtu si e parasheh edhe legjislacioni në fuqi.

Plani i buxhetit i KQZ-së është strukturuar në atë mënyrë ku në pjesën e parë të këtij dokumenti është paraqitur propozim buxheti i KQZ-së 2023-2025 dhe pastaj është vazhduar me propozim-buxhetin sipas viteve, programeve dhe kategorive ekonomike. Të gjitha vlerat buxhetore janë paraqitur në valutë-Euro.

Si përfundim, ky dokument përmban kërkesat buxhetorë në funksion të përmbushjes së nevojave dhe obligimeve të shpenzimeve operacionale dhe kërkesave për avansim në organizim, administrim sa më cilësor të proceseve zgjedhore.

PLANI I BUXHETIT 2023-2025

Misioni i KQZ-së është të organizojë zgjedhje kredibile dhe me standarde të larta, dhe ka për qëllim të ju ofrojë qytetarëve dhe subjekteve politike mundësi dhe shërbime cilësore zgjedhore.
Në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet, Planin e Punës dhe analizës së shpenzimeve të realizuara në procese zgjedhore dhe jo zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas udhëzimeve dhe instruksioneve të dhëna nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka përgatitur Planin e buxhetit për vitet 2023-2025.
Bazë për hartimin e Planit të buxhetit për vitet 2023-2025 ka shërbyer Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025 dhe janë harmonizuar kërkesat e njësive me obligimet të cilat rrjedhin nga Ligji mbi Zgjedhjet.

Hartimi i buxhetit për vitin 2023 është mbështetur edhe në Qarkoren buxhetore 2023/01 ku thuhet se Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i lejohen rritjet ne krahasim me vlerësimet e hershme për vitin 2023 në zbatimin e Ligjit të partive politike në momentin që fillon zbatimi i tij. Rritjet sipas Qarkores 2023/01 janë planifikuar në këto kategori:

- Shtatë (7) punëtorë shtesë për zbatimin e ligjit të partive politike si dhe buxheti i planifikuar për paga dhe shtesa për pagesën e tyre është 53,514 Euro dhe
- Mallra dhe shërbime 214,000 Euro për punëtoret shtesë,

Në buxhetin për vitin 2023 përveç buxhetit operacional dhe për ngritje te kapaciteteve dhe per fuqizim institucional, nuk është planifikuar buxhet për zgjedhje të parakohshme dhe as zgjedhje të jashtëzakonshme.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet[1] në rast se paraqitet nevoja për Zgjedhje të Jashtëzakonshme apo të parakohshme, atëherë KQZ-ja sipas legjislacionit në fuqi i drejtohet me kërkesë për buxhet shtesë Qeverisë e cila përmes mekanizmave duhet të i sigurojë mjetet për mbajtjen e zgjedhjeve.

Fokusi në planifikimin e buxhetit për vitet 2024 dhe 2025, ishte në zbatimin e objektivave dhe adresimin e çështjeve që janë ndërlidhur me zhvillimin e aktiviteteve të rregullta mbështetëse ne përgatitjet dhe gatishmërinë për organizimin e dy proceseve zgjedhore në vitin 2025. Në vlerësimet buxhetore për këto dy vite kanë shërbyer raportet dhe analizat e shpenzimeve të realizuara në proceset zgjedhore parlamentare dhe lokale të mbajtura në vitin 2021.

Buxheti për vitet 2023-2025 është planifikuar për tri programet:

- ✓ 14100-Programi i Sekretariatit në të cilin janë përfshirë shpenzimet operacionale ;

[1] Neni 66.8 Ligjit për Zgjedhjetnr.03/L-073

- ✓ 14200 - Programi i Zgjedhjeve është planifikuar buxheti për zhvillimin e aktiviteteve të rregullta për përgatitjen e proceseve zgjedhore dhe
- ✓ 10400 - Mbështetja e Partive Politike – subvencionet përmes të cilave mbështeten aktivitetet e subjekteve politike.

Në bazë të vlerësimeve të bëra si dhe nga kërkesat e njësive kërkuese, plani i buxhetit total i KQZ-së në të cilin janë përfshirë buxhetet e tri programeve dhe sipas kategorive ekonomike për tri vitet e ardhshme është:

Plani i buxhetit për vitin 2023	**Euro**
Paga dhe shtesa	1,290,891
Mallra dhe shërbime	748,998
Shpenzime komunale	28,100
Subvencione dhe transfere	4,620,000
Shpenzime kapitale	130,000
Total	**6,817,989**

Vlerësimi i buxhetit për vitin 2024	**Euro**
Paga dhe shtesa	1,337,891
Mallra dhe shërbime	1,836,481
Shpenzime komunale	24,600
Subvencione dhe transfere	4,620,000
Shpenzime kapitale	-
Total	**7,818,972**

Vlerësimi i buxhetit për vitin 2025	**Euro**
Paga dhe shtesa	1,383,891
Mallra dhe shërbime	17,400,319
Shpenzime komunale	51,600
Subvencione dhe transfere	4,620,000
Shpenzime kapitale	3,600
Total	**23,459,410**

Buxheti i planifikuar dhe vlerësuar sipas programeve 2023-2025:

Kategoritë	Buxheti i aprovuar	Buxheti i planifikuar	Vlerësuar	Vlerësuar
	2022	2023	2024	2025
Paga dhe shtesa				
Mallra dhe shërbime				
Spenzimet komunale				
Transferetdhe subvencionet	4,200,000	4,620,000	4,620,000	4,620,000
Shpenzimet kapitale			-	-
Gjithsej	**4,200,000**	**4,620,000**	**4,620,000**	**4,620,000**

Tabela 1- Buxheti për Fondin Mbështetja e Partive Politike

Kategoritë	Buxheti i aprovuar	Buxheti i planifikuar	Vlerësuar	Vlerësuar
	2022	2023	2024	2025
Paga dhe shtesa	1,115,253	1,290,891	1,337,891	1,383,891
Mallra dhe shërbime	509,998	622,998	599,885	970,935
Spenzimet komunale	27,600	28,100	23,100	28,100
Transferet				
Shpenzimet kapitale		80,000	-	-
Gjithsej	**1,652,851**	**2,021,989**	**1,960,876**	**2,382,926**

Tabela 2 - *Buxheti i Sekretariatit sipas kategorive ekonomike 2023-2025*

Kategoritë	Buxheti i aprovuar	Buxheti i planifikuar	Vlerësuar	Vlerësuar
	2022	2023	2024	2025
Paga dhe shtesa				
Mallra dhe shërbime	25,000	126,000	1,236,595.65	16,429,384.00
Spenzimet komunale	36,100		1,500	23,500
Transferet				
Shpenzimet kapitale		50,000		3,600
Gjithsej	**61,100**	**176,000**	**1,238,096**	**16,456,484**

Tabela 3 - *Buxheti i Zgjedhjeve sipas kategorive ekonomike 2023-2025*

1. Buxheti për vitin 2022 dhe parashikimi i implementimit

Me ligj të Buxhetit numër 08-L-066, për vitit 2022, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i janë caktuar fonde në programet të Sekretariatit, të Zgjedhjeve dhe Mbështetje për partitë politike në shumë prej 5,913,951 Euro. Buxheti i aprovuar sipas kategorive ekonomike kishte këtë strukturë: paga dhe shtesa 1,115,253 Euro, mallra dhe shërbime 534,998 Euro, shpenzime komunale 63,700 Euro dhe Subvencione dhe transfere 4,200,000 Euro.

Deri në fund të majit 2022, buxheti i shpenzuar i KQZ-së është në shumë prej 2,637,538 Euro dhe shprehur në përqindje buxheti është shpenzuar 45,6%. Raporti përfshin shpenzimet e realizuara për tri programet deri në fund të muajit maj të këtij viti.

Organizata buxhetore	Viti 2022 i buxhetuar	Shpenzimet deri më 31.05.2022	Rishikim	Mjetet për tu implementuar deri më 31.12.2022	Komente
Total	**5,913,951**	**2,637,538**	-	**3,276,413**	
Numri i punëtorëve	86	86		86	
Paga dhe shtesa	**1,115,253**	**443,508**		**671,745**	
Mallra dhe shërbime	**534,998**	**88,677**		**446,321**	
Shpenzime komunale	**63,700**	**5,354**		**58,346**	
Subvencione dhe transfere	4,200,000	2,100,000		**2,100,000**	
Shpenzime kapitale	-			-	
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	**5,913,951**	**2,637,538**	-	**3,276,413**	
Financimi nga të hyrat e AKP-së					
Të hyrat vetanake					
Financimet nga huamarrjet					
Financimi nga deficiti buxhetor (2%) - 04					
Financimi nga Klauzola e investimeve -06					

Tabela 4. Buxheti për vitin 2022[2]

[2] Raporti nga SIMFK

2. Plani i Buxhetit për vitin 2023

Propozim-Plani i buxhetit në vitin 2023 për tri programet: Fondi për mbështetje te partive politike (10400), Sekretariatin (14100) dhe Zgjedhjet (14200) është në vlerë prej 6,817,989 Euro.

Në paga dhe shtesa kërkesat buxhetore janë 1,290,891 Euro, mallra dhe shërbime 748,998 Euro shpenzime komunale 28,100 Euro, subvencione dhe transfere 4,620,000 Euro dh shpenzime kapitale 130,000 Euro.

Në tabelë është paraqitur buxheti i planifikuar i KQZ-së për vitin 2023

Kategoritë	Buxheti i planifikuar I KQZ-së
	2023
Paga dhe shtesa	1,290,891
Mallra dhe shërbime	748,998
Shpenzimet komunale	28,100
Transferet	4,620,000
Shpenzimet kapitale	130,000
Gjithsejt	6,817,989

Tabela 5- Buxheti për vitin 2023

Plani i buxhetit 2023-2025 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve paraqet planin për vitin 2023 ndërsa për dy vitet tjera është vetëm vlerësim. Buxheti është planifikuar në tri programe si:

- Në Sekretariat janë planifikuar fuqizimi institucional i KQZ-se si dhe shpenzimet tjera operacionale dhe pagat dhe shtesat për stafin e punësuar në KQZ,
- Në Zgjedhje është planifikuar buxhet për avancim të proceseve zgjedhore
- Në Fondin mbështetja e partive politike është planifikuar buxhet për subjektet politike që kanë fituar ulëse në Kuvend të Kosovës dhe për grupet parlamentare.

2.1. Buxheti sipas programeve për vitin 2023

Sekretariati

Në kuadër të programit të Sekretariatit është planifikuar buxheti për vitin 2023 në shumë prej 2,021,989 Euro. Buxheti i planifikuar në Sekretariat përmban buxhetin për paga dhe shtesa në vlerë prej 1,290,891 Euro, të mallrave dhe shërbimeve 622,998 Euro, të shpenzimeve komunale 28,100 Euro dhe në kategorinë e investimeve kapitale janë planifikuar 80,000 Euro.

Kategoritë	Buxheti i aprovuar	Buxheti i planifikuar
	2022	2023
Paga dhe shtesa	1,115,253	1,290,891
Mallra dhe shërbime	509,998	622,998
Spenzimet komunale	27,600	28,100
Transferet		
Shpenzimet kapitale		80,000
Gjithsej	**1,652,851**	**2,021,989**

Tabela 6- Buxheti i Sekretariatit 2023 - sipas kategorive ekonomike

Paga dhe shtesa

Buxheti për vitin 2023 në kategorinë e pagave dhe mëditjeve me Qarkoren buxhetore 2023/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, është i planifikuar për 93 zyrtarë në shumë prej 1,174,343 Euro. Me Qarkoren buxhetore 2023/01 për vitin 2023, KQZ-së i janë lejuar 7 pozita te reja si dhe buxheti shtesë ne vlere prej 53,514 për pozitat të cilat mund te implementohen me hyrjen ne fuqi te ligjit për subjektet politike.

Ndërkaq, kërkesat e KQZ-se për buxhet ne paga për vitin 2023 janë në shumë prej 1,290,891 Euro për 99 zyrtarë. Aktualisht KQZ-ja i ka te aprovuar me Ligjin e buxhetit[3] 86 pozita. Me Qarkore buxhetore janë aprovuar shtatë (7) pozita të cilat pritet te implementohen me hyrjen ne fuqi te ligjit për parti politike. Mirëpo, sipas vlerësimeve te ZRPPC-së, sipas aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe Rregullores së Organizimit të Brendshëm të KQZ-së, për pavarësinë funksionale, organizative dhe klasifikimin e vendeve të punës, buxheti për këto pozita duhet te jetë 80,370 €uro, apo 26,856 Euro me shumë se buxheti i dhënë në Qarkore për

[3] Ligji i buxhetit 08/L-066

këtë qëllim. Po ashtu KQZ-ja ka aprovuar edhe 6 pozita tjera te cilat asnjëherë deri me tani nuk janë aprovuar dhe buxhetuar nga Qeveria..

Kërkesat buxhetore shtese për buxhet ne paga për vitin 2023 janë ne vlere prej 116,548 Euro me shume se buxheti i dhënë ne kufijtë buxhetor te Qarkores 2023/01.

Mallra dhe shërbime

Plani i buxhetit i Sekretariatit për vitin 2023 në mallra dhe shërbime është planifikuar për fuqizimin institucional te KQZ-së dhe shërbimet tjera operacionale. Ne buxhetin e planifikuar për mallra dhe shërbime në vlerë prej 622,998 Euro prej te cilave sipas Qarkores 2023/01 214,000 Euro janë për implementimin e ligjit për subjektet politike.

Ne buxhetin e Sekretariatit në mallra dhe shërbime për vitin 2023 është planifikuar buxheti për këto qëllime:

- ✓ 210,000 Euro Auditimi i Raporteve Vjetore Financiaret te PP-ve dhe Raportet e Fushatës se SP-ve;
- ✓ 28,500 Euro furnizim me kompjuter për ZLKZ
- ✓ 87,500 Euro shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit,
- ✓ 50,000 Euro Qira me vetura,
- ✓ 35,575 Euro shërbimet e telekomunikimit,
- ✓ 23,000 Euro për trajnim
- ✓ 30,300 Euro mirëmbajtje (te veturave, ndërtesave TI, pajisje)
- ✓ 29,000 Euro blerje tjera - furnizime për zyre, furnizim me uje
- ✓ 25,000 Euro derivate për vetura,
- ✓ 15,960 Euro shpenzimet e përfaqësimit
- ✓ 15,000 Euro shpenzimet e anëtarësimit,
- ✓ 24,238 Euro për blerje te mobileve (karrika, tavolina dhe dollap)

Ndërkaq pjesa tjetër e buxhetit te planifikuar ka te beje me regjistrim dhe sigurim te veturave, me shpenzime te marketingut, qiratë e ndërtesave, konkurse etj.

Shpenzimet komunale

Buxheti i shpenzimeve komunale te planifikuara në Sekretariat për vitin 2023 është në vlerë prej 28,100 Euro buxhet ky i cili do të i mbuloj shpenzimet e telefonisë fikse (3,600 Euro), energjisë elektrike (22,000 Euro) dhe mbeturinave (1,800 Euro).

Shpenzimet kapitale

Në Qarkoren buxhetore 2023/01 KQZ-së nuk i është aprovuar buxhet për shpenzime kapitale. Me gjithë atë për vitin 2023, në shpenzimet kapitale ne kuadër te Sekretariatit janë planifikuar 80,000 Euro, prej të cilave:

- ✓ 30,000 Euro –rregullimi i dhomës se serverëve,

- ✓ 30,000 Euro Programi për bazën e te dhënave për raportet financiare te Partive,
- ✓ 20,000 Euro për blerjen e softuerit për sistemin e menaxhimit të buxhetit dhe financave,

Zgjedhjet

Kërkesa buxhetore të planifikuara në programin e zgjedhjeve për vitin 2023 janë si nevojë për ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve për mbajtje dhe organizim të zgjedhjeve sa më cilësore. Duke pasur parasysh Ligjin për Zgjedhjet, viti 2023 nuk do te jete vit zgjedhor, prandaj nuk është planifikuar buxhet për organizim të rregullt të procesit zgjedhor.

Mirëpo në rast se merren vendime nga organet kompetente për mbajtje të zgjedhjeve të jashtëzakonshme apo të parakohshme, atëherë KQZ ja i drejtohet Qeverisë me kërkesë për fonde shtesë.

Në programin e Zgjedhjeve për vitin 2023 janë planifikuar 176,000 Euro nga te cilat per mallra dhe shërbime 126,000 Euro dhe investime kapitale 50,000 Euro.

Ne mallra dhe shërbime buxheti është planifikuar:

- ✓ 50,000 Euro Draft Projekti "Informimi i votuesve"
- ✓ 50,000 Euro për kuti te votimit
- ✓ 10,000 Euro për kapak te kutive te votimit,.
- ✓ 10,000 Euro –simulim i procesit zgjedhor
- ✓ 4,000 Euro- Konkursi për kompozimin e "Melodisë së KQZ-se"
- ✓ 2,000 Euro dita globale e zgjedhjeve

Per kategorinë e investimeve kapitale janë planifikuar

- ✓ 50,000 Euro per projektin Identifikimi Elektronik i votuesve

Në tabelën më poshtë është paraqitur plani i buxhetit në programin e Zgjedhjeve sipas kategorive:

Kategoritë	**Buxheti i aprovuar**	**Buxheti i planifikuar**
	2022	2023
Paga dhe shtesa		
Mallra dhe shërbime	25,000	126,000
Spenzimet komunale	36,100	
Transferet		
Shpenzimet kapitale		50,000
Gjithsej	**61,100**	**176,000**

Tabela 7–Buxheti i Zgjedhjeve 2023 sipas kategorive ekonomike

3.1.3. Fondi për mbështetje te subjekteve politike

Buxheti i planifikuar në subvencione dhe transfere që ka të me përkrahjen e subjekteve politike është planifikuar për vitin 2023 në vlerë prej 4,620,000 Euro apo 10% më shumë se buxheti i i aprovuar për vitin 2022.

Pra buxheti për fondin është planifikuar te jetë me i larte se kufijtë e caktuar buxhetor në Qarkoren 2023/01 për 420,000 Euro.

Me Ligjin Nr. 04/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike përkatësisht neni 3 i këtij ligji thuhet se "Shuma e mjeteve buxhetore dedikuar Fondit për mbështetjen e subjekteve politike nuk mund të kalojë 0.34% të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Andaj në caktimin e lartësisë së buxhetit të Fondit të merret parasysh neni i cituar më lartë

3.2. Vlerësimi i Buxhetit për vitin 2024 sipas programeve

Vlerësimet për kërkesat buxhetore në vitin 2024 janë më të larta sepse janë planifikuar kryesisht shpenzimet operacinale, për përkrahje dhe avancim të proceseve zgjedhore si tërësi si dhe buxheti për mbështetje të partive politike.

Buxheti i vlerësuar për tri programet është në vlerë prej 7,818,972 Euro, nga i cili për paga dhe shtesa 1,337,891 Euro, mallra dhe shërbime: 1,836,481 Euro, shpenzime komunale 24,600 Euro dhe subvencione e transfere 4,620,000 Euro.

3.2.1. Sekretariati

Në Sekretariat Buxheti i planifikuar për vitin 2024 është 1,960,876 Euro nga të cilat në paga dhe shtesa janë planifikuar 1,337,891 Euro për 99 zyrtarë, në mallra dhe shërbime 599,885 Euro, në shpenzime komunale 23,100 Euro.

Kategoritë	**Vlerësuar**
	2024
Paga dhe shtesa	1,337,891
Mallra dhe shërbime	599,885
Spenzimet komunale	23,100
Transferet	
Shpenzimet kapitale	-
Gjithsej	**1,960,876**

Tabela 8. Buxheti i Sekretariatit 2024 sipas kategorive ekonomike

3.2.2. Zgjedhjet

Viti 2024 vlerësohet si vit jo zgjedhor. Por duke pasur parasysh se zgjedhjet parlamentare janë mbajtur në shkurt te vitit 2021, është vlerësuar se data e zgjedhjeve mund te caktohet ne tre mujorin e fundit te vitit 2024. Disa aktivitete zgjedhore duhet te fillojnë menjëherë pas caktimit te datës se zgjedhjeve për te cilat është vlerësuar te planifikohen ne buxhetin e vitit 2024 dhe vlera e tyre është 1,238,096 Euro.

Kategoritë	Vlerësuar
	2024
Paga dhe shtesa	
Mallra dhe shërbime	1,236,596.00
Spenzimet komunale	1,500
Transferet	
Shpenzimet kapitale	
Gjithsej	**1,238,096**

Tabela 9–Buxheti i Zgjedhjeve 2024 sipas kategorive ekonomike

3.2.3. Fondi mbështetja e partive politike

Në programin mbështetja e partive politike buxheti për vitin 2024 është 4,620,000 Euro i planifikuar njëjtë sikurse edhe një vit më parë.

3.3. Vlerësimi i Buxhetit për vitin 2025 sipas programeve

Për vitin 2024 buxheti është i vlerësuar dhe arrin në vlerë prej 23,459,410 Euro nga i cili për paga dhe shtesa është 1,383,891 Euro, në mallra dhe shërbime 17,400,319 Euro, shpenzime komunale 51,600 Euro, subvencione e transfere 4,620,000 Euro dhe në kapitale 3,600 Euro.

3.3.1. Sekretariati

Në Sekretarit, për vitin 2025 është vlerësuar buxheti në vlerë prej 2,382,926 Euro nga i cili në paga dhe shtesa 1,383,891 Euro.

Në mallra dhe mallra dhe shërbime vlerësohet të jetë buxheti në shumë prej 97,935 Euro, ndërsa shpenzimet komunale vlerësohen në shumë prej 28,100 Euro.

Kategoritë	**Vlerësuar**
	2025
Paga dhe shtesa	1,383,891
Mallra dhe shërbime	970,935
Spenzimet komunale	28,100
Transferet	
Shpenzimet kapitale	-
Gjithsej	**2,382,926**

Tabela 10. Buxheti i Sekretariatit 2025 sipas kategorive ekonomike

3.3.2. Zgjedhjet

Në programin e Zgjedhjeve për vitin 2025 i sipas Ligjit te zgjedhjeve do të ketë zgjedhje të rregullta parlamentare dhe lokale. Në rast se caktohet mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme apo të jashtëzakonshme KQZ-ja i drejtohet Qeverisë për fonde shtesë.

Në vitin 2025 buxhetit planifikuar në këtë program është në vlerë prej 16,456,484.26 Euro prej të cilave në mallra dhe shërbime 16,429,384 Euro në shpenzime komunale 23,500 Euro dhe shpenzime kapitale 3,600 Euro.

Kategoritë	Vlerësuar
	2025
Paga dhe shtesa	
Mallra dhe shërbime	16,429,384.00
Spenzimet komunale	23,500
Transferet	
Shpenzimet kapitale	3,600
Gjithsej	**16,456,484**

Tabela 11. Buxheti i Zgjedhjeve 2025 sipas kategorive ekonomike

3.3.3. Mbështetja e partive politike

Në vitin 2025 është vlerësuar buxheti të jetë në vlerë prej 4,620,000 Euro i cili është në përputhje me buxhetin e Qarkores 2023/01.

4. Kërkesat shtesë buxhetore mbi kufijtë buxhetor të Qarkores 2023/01

Kërkesat buxhetore të KQZ-së për vitin 2023 janë në shumë prej 6,817,989 Euro apo për 630,948 Euro më shumë se buxheti i caktuar me Qarkoren buxhetore 2023/01.

Në paga dhe shtesa kërkesat janë më të larta për 116,548 Euro. Këtu është llogaritur edhe buxheti për 7 zyrtarë, pozita këto aprovuara ne Qarkoren buxhetore 2023/01 te cilat implementohen me hyrjen ne fuqi te ligjit pe partitë politike dhe 6 pozita te aprovuara nga KQZ.

Në mallra dhe shërbime kërkesat buxhetore të KQZ-së janë në kufijtë buxhetor te dhënë ne Qarkoren 2023/01.

Në kategorinë e shpenzimeve komunale buxheti në Qarkore është më i lartë se nevojat dhe kërkesat e KQZ-së për 35,600 Ero.

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale, me Qarkoren buxhetore KQZ-së nuk i është dhënë fare buxhet. Ndërkaq nevojat dhe kërkesat e KQZ-së në këtë kategori janë për 130,000 Euro për realizimin e këtyre projekteve

- ✓ 50,000 Euro -Identifikimi Elektronik i votuesve
- ✓ 30,000 Euro –rregullimi i dhomës se serverëve,
- ✓ 30,000 Euro Programi për bazën e te dhënave për raportet financiare te Partive,
- ✓ 20,000 Euro- softueri për sistemin e menaxhimit të buxhetit dhe financave,
- ✓ 420,000 Euro - buxheti për fondin është planifikuar te jetë me i larte se kufijtë e caktuar buxhetor në Qarkoren 2023/01

Kategoritë	Buxheti i planifikuar I KQZ-së	Buxheti sipas Qarkorës 2023/01	Ndryshimi
	2023	2023	
Paga dhe shtesa	1,290,891	1,174,343	116,548
Mallra dhe shërbime	748,998	748,998	-
Shpenzimet komunale	28,100	63,700	(35,600)
Transferet	4,620,000	4,200,000	420,000
Shpenzimet kapitale	130,000		130,000
Gjithsejt	6,817,989	6,187,041	630,948

Tabela 12- Buxheti i KQZ-së dhe kufijtë buxhetor[4]

[4] Qarkorja buxhetore 2023/01

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarlna Izborna Komisija
Central Election Commission
21 -06- 2022
Prishtinë / Priština

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Nr./Br. 840 - 2022

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 21.06.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Z.Labinot Maliqi,** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga subjekti politik "Aleanca Kosova e Re", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Valon Maliqi.

II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Labinot Maliqi, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 07.06.2022, Nr.763/2022, për zëvendësimin e anëtari të Kuvendit Komunal z.Valon Maliqi, me rastin e dorëheqjes së tij, për arsye personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati në listën e rirenditur është z.Labinot Maliqi.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.06.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi